



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/22

Datë: 03.04.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësive administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 3 prill 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept-dokumenti për Banim Social.
2. Obligohet Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe institucionet tjera për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAJA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

*Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor/ Ministarstvo Sredine i Prostornog
Planiranja/ Ministry of Environment and Spatial Planning*

KONCEPT DOKUMENTI PËR BANIM SOCIAL

Hyrje

Dokumentet qeveritare për autorizimin e përgaditjes së koncept dokumentit janë: Plani i Punës së Qeverisë, Plani i Punës së Ministrisë (Objektivi 5: Kompletimi i infrastruktures ligjore, pika 5.2 Hartimi i koncept dokumentit për nevojat e ndryshim plotësimit të Ligjit të për financimin e programeve të veçanta të banimit), Programi legjislativ për vitin 2014, Buxheti dhe strategjitë e hartuara në nivel qeveritar të cilat në vehte përmbajnë aktivitete për zgjidhjen e problemit të banimit si: Strategjia e komunitetit rome, ashkali dhe egjiptian, Strategjia e kthimit dhe komuniteteve, Strategjia kombëtare për riintegrimin e personave të riatdhesuar duhet të bazohen në bazë të ligji në fuqi.

Me gjithë aktivitetet e Qeverisë, Komunave dhe të donatorëve që nga pas lufta, për zgjidhjen e çështjes, ende mbetet sfidë problemi i banimit për shumë familje në Kosovë. Kjo është si pasojë e luftës së fundit si dhe gjendjes së rëndë ekonomike në vend.

Pas fazës së rindërtimit (1999-2002) të bazuar në udhëzuesin për rindërtim dhe programit e udhëzuesit për banim social për ndërtimin e banesave sociale (2003-2007), MMPH harton Ligjin për financimin e programeve të veçanta të banimit i cili synon strehimin e familjeve me të ardhura të ulëta duke pasur pak dispozita ku i lihet mundësia komunave që të bashkë-financojnë me donatorë që të trajtojnë edhe familjet me asistencë sociale nëpërmjet programit me bonus banimi. Në bazë të dhënave të komunave kuptojmë se numri i familjeve që jetojnë nën norma të banimit dhe që janë me asistencë sociale mbetet ende i madh, kurse ligji në fuqi nuk ofron zgjidhje adekuate për të adresuar këtë problem.

Mungesa e buxhetit si në nivelin qendror dhe lokal, mungesa e strukturës përkatëse administrative për banim në nivelin lokal por edhe jo harmonizimi i përkrahjeve të donatorëve ka rezultuar në zgjidhje të kufizuara për banim. Gjithashtu, strategjitë e lartpërmendura që janë të hartuara në nivel qeveritar kërkojnë zgjidhjen e problemit të banimit për kategoritë e synuara.

Gjatë zbatimit të strategjive është vërejtë që zgjidhjet ad-hoc nuk janë të qëndrueshme dhe janë shumë më të kushtueshme.

Për më tepër, nga procesi i liberalizimit të vizave, përveç tjerash, Kosova ngarkohet me detyrim të plotësoj kërkesat për zgjidhjen e çështjes së banimit për personat e riatdhesuar pa vullnetin e tyre nga shtetet e BE-së. Aktualisht nga Fondi për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar ofrohet zgjidhja e banimit për familjet apo individët që kanë shtëpi të dëmtuar ose të rrënuar plotësisht kurse për familjet ose individët që nuk kanë pronë (shtëpi ose banesë) u ofrohet zgjidhje e përkohshme (6 muaj + 6 muaj) çka pas këtij afati kohor mbeten barrë e komunave.

Duke pasur parasysh të gjitha çështjet e cekura më lartë është konsideruar e domosdoshme shqyrtimi i politikave ekzistuese për të identifikuar mangësitë dhe propozuar opsione tjera për zgjidhjen e problemeve të lartpërmendura.

Obligim i Qeverisë është mirëqenia e qytetarëve të vet. Kjo rregullohet me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Neni 22 i cili thotë: Të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare nëvijim, garantohen me këtë Kushtetutë,

zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike:

1. Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut;
2. Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saja;
3. Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e saj;
4. Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare;
5. Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor;
6. Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas;
7. Konventa për të Drejtat e Fëmijës;
8. Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese.
9. Deklarata Ekonomike Sociale

Republika e Kosovës ka marrë për obligim miratimin e kornizës ligjore në harmoni të plotë me konventat e BE-së, i cili është parakusht esencial për përafrimin me BE-në.

Definimi i çështjes/problemit kryesor

Në Kosovë pas luftës numri i shtëpive të dëmtuara ka qenë 120.000 ku 45.000 prej tyre janë vlerësuar si tërësisht të dëmtuara. Nga donatorët ndërkombëtarë janë rindërtuar rreth 60.000 shtëpi. Sipas raportit të Departamentit të Banimit dhe Ndërtimit të MMPH-së, të bazuar në kërkesat e regjistruara në Komuna gjendja e banimit është e rëndë si rezultat i një numri të konsiderueshëm të shtëpive të shkatërruara, rasteve të shumta sociale, migrimit të brendshëm, ndryshimit të strukturës familjare, çmimeve të larta të shitblerjes së patundshmërive etj.

Në bazë të databazës të vitit 2010 nga raportet e Komunave të Kosovës janë evidentuar 37 Qendra të Përkohshme Kolektive me 1.419 familje dhe 3.996 banorë, shumë familje duke jetuar nën norma të banimit. Kushtet e banimit në këto vende nuk i plotësojnë standardet minimale për banim dhe karakterizohen me mungesë të hapësirës, mungesë të mirëmbajtjes së objekteve dhe si rezultat objektet janë të dëmtuara. Përveç kësaj, edhe kushtet higjienike janë të ulëta dhe ka mungesë të madhe të ujit, të ngrohjes, etj. Këto familje jetojnë kryesisht me asistencë sociale, shumica nuk posedojnë pronë/pasuri të paluajtshme, ndërsa me forcat e veta financiare-materiale nuk mund të zgjidhin çështjen e banimit madje as me dekada. Situatën e rëndon edhe më tepër ekzistimi i Vendbanimeve joformale (VBJ-ve), si dhe procesi i riintegritimit të personave të riatdhesuar.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) si ministri e linjës për banim është përgjegjëse për legjislacionin e fushës së banimit. Departamenti i Planifikimit Hapësinor Ndërtimit dhe Banimit (DPHNB) është drejtpërdrejt përgjegjës për përgatitjen dhe zbatimin e kornizës ligjore për banimit, i cili për momentin ka numër të kufizuar të stafit (vetëm 3).

MMPH, që nga viti 2002 kur është themeluar, ka marrë mandatin në rregullimin e fushës së banimit.

Përmes programit për banim social (2003-2007) MMPH ka synuar zbutjen e gjendjes së rendë aktuale të banimit duke ndërtuar 9 ndërtesa me banesa sociale në pronësi të Komunave (Deçan, Skenderaj, Klinë, Mitrovicë, Malishevë, Gjilan, Obiliq, Lipjan- Magurë dhe Gjakovë) që ofrojnë banim me qira joprofitabile. Në këtë periudhë kohore janë ndërtuar ndërtesa me banesa sociale edhe nga MPMS, MKK si dhe donatorë të ndryshëm pa ndonjë koordinim.

MMPH është përgjegjëse për përgatitjen e strategjisë trevjeçare të banimit social, në bazë të nevojave të pranuar nga komunat programet trevjeçare të banimit të komunave MMPH, me Ligjin Nr. 03/L-164 për financimin e programeve të veçanta të banimit (Gazeta Zyrtare Nr. 67/29, Mars 2010), synoi krijimin e kushteve për banim të qëndrueshëm për familjet ose individët të cilët nuk janë në gjendje ekonomike t'i përballojnë ofertat e tregut të lirë të banesave si dhe caktimi i mënyrës së sigurimit dhe shfrytëzimit të mjeteve financiare për zhvillimin e programeve të veçanta të banimit. Përmes këtij ligji janë të përcaktuar dy programe:

1. Programi për **banim me qira joprofitabile** dhe
2. Programi me **bonus banimi**.

Qiraja joprofitabile - zbatohet në banesat e ndërtuara nga Komuna, Qeveria dhe Donatorët dhe **Bonus banimi** - zbatohet kur komuna financon gjysmën e qirasë së tregut në banesa ekzistuese në pronësi të personave fizikë apo juridikë.

Gjithashtu në bazë të këtij ligji, Komunat janë përgjegjëse për sigurimin e zonave për ndërtim dhe pajisjen e truallit me infrastrukturë që duhet të realizohen në bazë të programeve tre (3) vjeçare komunale për banim, të cilat mundësojnë sigurimin e banimit të gjitha kategorive dhe përfshirjen e kategorive të strategjive në nivelet qeveritare.

Struktura institucionale që ka të bëjë me banimin kryesisht është e përcaktuar në Ligjin për FPVB-në dhe i cili përcakton se përgjegjësitë për programet, financimin dhe monitorimin/inspektimin i përkasin institucioneve të nivelit qendror (MMPH-së dhe KQB) dhe për zbatimin, e në masë më të vogël, për financimin e projekteve, përgjegjësia u përket nivelit lokale.

Përveç strukturës së lartcekur, e cila është ngritur ekskluzivisht për të krijuar sistemin kombëtar të banimit social, nuk ka institucione të tjera shtetërore që janë drejtpërdrejtë të përfshira në sigurimin e banimit social.

Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) është përgjegjëse për menaxhimin e Fondit për Ri-integrimin e Personave të Riatdhesuar (FRPR) i cili është themeluar për të siguruar riatdhesimin e qëndrueshëm të qytetarëve kosovarë që kthehen në mënyrë të pavullnetshme nga vendet e BE-së. Pjesa kryesore e fondeve i dedikohet banimit, por deri më sot ato kryesisht janë përdorur për të paguar ndihmën financiare për bonus banimit për periudhën 6 mujore me mundësi vazhdimi edhe për 6muaj në akomodimet private dhe, në masë të kufizuar, për renovim dhe ndërtim të ri të shtëpive të përfituesve individualë. Në vitin 2013 është vendosur që fondet të kanalizohen përmes MMPH-së dhe janë transferuar 1 milionë euro, prej të cilave vetëm rreth një e treta është shpenzuar. Në vitin 2013 MPB i ka ndihmuar 58 familje, ndërsa 155 familje për momentin konsiderohen se janë pa zgjidhje të qëndrueshme të banimit.

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) është përgjegjëse për ofrimin e banimit social për qytetarët në gjendjen më të vështirë, ku në radhë të parë hyjnë veteranët e luftës, invalidët e luftës dhe familjet RAE. Në periudhën 2008-2013 janë ndërtuar 278 njësi banimi. MPMS e ka një departament të banimit për ndërtim i cili i zbaton projektet e banimit, ndërsa prona ku ndërtohen objektet e banimit është e komunës. Mesatarisht çdo vit ndërtohet nga një bllok i banimit për afërsisht 0.5 milionë euro. Për këto banesa nuk mbliidhet qira.

Ministria për Komunitete dhe Kthim (MKK) është kryesisht përgjegjëse për të ndihmuar PZHBV-të dhe refugjatët nga Kosova që të kthehen në vendbanimet dhe shtëpitë e tyre të paraluftës. Çdo vit janë ndarë shuma të konsiderueshme për investime kapitale në renovimin dhe ndërtimet e reja të shtëpive individuale për të kthyerit dhe për përmirësimin e shërbimeve komunale (mesatarisht 6 milionë euro). Këto fonde janë shpenzuar në tërësi përmes projekteve të realizuara nga departamenti i specializuar i MKK-së. Partnerët e ndryshëm ndërkombëtarë po ashtu ndihmojnë në sigurimin e zgjidhjeve afatgjate të banimit, kryesisht duke përkrahur mbylljen e qendrave kolektive dhe duke siguruar banim për popullsinë RAE.¹

Komunat kanë ngecë në hartimin e programeve tre vjeçare të banimit dhe krijimin e strukturave administrative për banim si shkak të mos prioritizimit të çështjes së banimit në politikat komunale dhe mungesa e vullnetit në emërimin e strukturës organizative. Meqenëse ligji në fuqi ka përcaktuar që strategjia qendrore hartohet në bazë të programeve komunale të banimit ka ngecur edhe hartimi i strategjisë qendrore për banim.

Identifikimi i pengesave në zbatim të ligjit në fuqi kërkon hartimin e një ligji të ri ku do të evitoheshin zbrazëtitrat e ligjit në fuqi dhe do të përcaktoheshin dispozita që lehtësojnë zbatimin.

Prej legjislacionit të vjetër për shkak të zhvillimeve sa i përket çështjes pronësore dhe banesore ende është në fuqi Ligji për marrëdhënie banesore (Fletore zyrtare e KSAK nr. 11/83). Ligji i propozuar synon shfuqizimin e tij meqë është konsideruar që janë pjekur kushtet për këtë.

Me ligjin në fuqi janë synuar grupet me e ardhura të ulëta (150-300 €), duke pasur parasysh se kjo kategori e njerëzve ka mundësi të paguaj qiranë joprofitabile e cila sipas ligjit nuk ka mundur të jetë më e lartë se 30 % e të ardhurave të përgjithshme të familjes.

Kurse për familjet me asistencë sociale ligji në fuqi, respektivisht nenit 9 paragrafi 5 ka lënë mundësi vetëm në raste kur janë investimet nga burimet tjera (donatorë) që do të thotë mundësia për këtë kategori ka qenë shumë e vogël. Në këto raste vlera e qerasë e shprehur me €/m², përcaktohet për çdo rast specifik në bashkëpunim në mes subjekteve që financojnë dhe komunës ku zbatohet projekti dhe miratohet me vendim të Kuvendit Komunal.

Kategorizimi sipas këtij ligji nuk ka gjet zbatim andaj është konsideruar të propozohet kategorizim i ri duke rritur numrin e programeve.

¹ Raporti i vlerësimit i nevojave për banim social në Kosovë - nga zyra Zvicerane (ekspertet)

Kërkesat për zgjidhjen e çështjes së banimit nga viti në vit ndryshojnë. Në disa komuna ka trend të rritjes ndërsa disa komuna kanë ofruar përkrahje çdo vit mirëpo trendi mbetet i njëjtë. Në bazë të dhënave nga komunat nga periudha e pasluftës, numri i kërkesave për banim është përafërsisht rreth 3.000 familje në tërë Kosovën. Edhe pse ligji në fuqi ka përcaktuar krijimin e bazës së të dhënave për banim si në nivelin qendror dhe lokal po ashtu raportimin vjetor (muajin mars) të komunave këto dy aktivitete nuk janë zbatuar andaj rezulton në mungesë të të dhënave për kërkesat dhe zhvillimet në banim nëpër komunat e Kosovës për çdo vit.

Në bazë të ligjit në fuqi mundësitë e financimit janë të pakta, nga Buxheti i Kosovës, Komunave dhe Donatorë të mundshëm, prandaj është shumë e nevojshme të kemi forma të reja të financimit për të rritur mundësitë për implementimin e këtyre programeve p.sh. mundësitë e koncensionimit të tokës nga komunat dhe mënyra e projekteve partneriteteve publiko-privat me qëllim të shtimit të banesave me qira të subvencionuar, mundësitë për krijimin e OJQ-ve ose struktura të ngjashme me profit të limituar që do të merreshin me zhvillimin dhe menaxhimin e banesave me qira të subvencionuara nga shteti.

Mungesa e data-bazës së banimit në nivelin lokal dhe qendror pengon propozimin e politikave të reja adekuate për banim. Gjendja aktuale e të dhënave në mënyrë profesionale nuk eksiton duke pasur parasysh se nuk ka softuer ku do të regjistrohen kërkesat, investimet dhe numrin e zgjidhjeve të problemeve të banimit në nivelin lokal dhe qendror për të gjitha kategoritë.

Mënyra e përcaktimit të kufijve të të ardhurave dhe qirasë joprofitabile janë konsideruar si të komplikuar për zbatim andaj propozojmë thjeshtimin e mënyrës së përcaktimit të tyre.

Gjatë hartimit të udhëzimeve administrative që dalin në bazë dhe në zbatim të Ligjit Nr. 03/L-164 "Për financimin e programeve të veçanta të banimit", kanë dalë në pah disa probleme të karakterit teknik, të cilat pengojnë zbatimin efikas të këtij ligji, përputhshmërinë e tij me aktet tjera ligjore në fuqi me ndryshimin e të cilave afektohet zbatimi i këtij ligji si aktet ligjore që rregullojnë funksionimin e Gjykatave, aktet ligjore që rregullojnë administrimin e ndërtesave në bashkëpronësi dhe të ngjashme si dhe synojnë lehtësimin e kuptimit të këtij ligji si dhe vlerësohet e nevojshme bërja e disa përmirësime në përmbajtjen e këtij ligji.

Në Kosovë kemi një numër të madh të kategorive që kërkojnë zgjidhjen e çështjes së banimit siç janë personat me asistencë sociale, personat e të kthyer nga vendet e rajonit, familjet me të ardhura të ulëta, komunitetet romë ashkali dhe egjiptian, familjet e invalidëve dhe veteranëve të UÇK-së dhe familjeve të dëshmorëve, të ish burgosurve politik si dhe riintegrimin e personave të riatdhesuar. Prandaj, për zgjidhjen dhe trajtimin e kategorive të ndryshme është paraqitur nevoja e rritjes së numrit të programeve të banimit për të gjitha kategoritë përfituese.

Gjithashtu siç e cekëm më lartë problem paraqet edhe mos koordinimi në mes të shumë ministrive të cilat aktualisht po merren me zgjidhjen e çështjes së banimit për kategoritë e ndryshme dhe me politika të ndryshme duke mos respektuar ligjin në fuqi.

Politika aktuale nuk ka rol unifikues të aktiviteteve të përfshira në strategjitë e ndryshme qeveritare dhe nuk është në harmoni me dispozitat e funksionimit të komunave sipas Ligjit Nr. 03/L-040 "Për vetëqeverisjen lokale", neni 17, në pikat:

- a) zhvillimin lokal ekonomik;
- c) shfrytëzimin e tokës dhe zhvillimin dhe
- i) banimi publik.

Edhe pse problemet e shumta vijnë nga fusha e banimit, ngecje në zbatim të ligjit në fuqi ka paraqitë mos përfshirja e banimit në listën e prioriteteve si në nivel qendror ashtu në nivel lokal. Mungesa e një fondi të banimit pengon zgjidhjen e çështjes së banimit për të gjitha kategoritë e njerëzve, dhe çon në zgjidhjen parciale varësisht prej cilës strategji rrjedh. Ligji i ri si masë e propozuar synon koordinimin e projekteve të donatorëve dhe të bashkë-financuara me sektorin privat me qëllim të monitorimit të zbatimit të tyre.

Në shtetet e rajonit është konsideruar si mjaft i rëndësishëm roli i Organizatave joprotabile, në zbatimin e legjislacionit që veprojnë në fushën e ndërtimit dhe menaxhimit të banesave me qiraprofitabile. Në mungesë të masave stimuluese për krijimin e këtyre organizatave në Kosovë ende nuk kanë filluar së funksionuar edhe pse janë parapa me ligjin në fuqi.

Politika aktuale - Korniza institucionale për zbatimin e politikave aktualisht është: MMPH, Autoritet Komunale, Këshilli Qendror për Banim, Organizata joprotabile, Donatorët dhe organizatat ndërkombëtare.

MMPH - autoriteti përgjegjës për hartimin e politikave të përgjithshme të banimit dhe mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit dhe ka përgjegjësin e hartimit të strategjisë për banim, krijimin e bazën së të dhënave në nivel qendror, ndihmon komunat në funksion të hartimit dhe zbatimit të politikave për banim, planifikimin e buxhetit për mbështetjen e programeve të banimit si dhe përcakton koston mesatare vjetore për ndërtimin e banesave.

Autoritet Komunale - përgjegjës për implementimin e ligjit dhe inspektimin. Kanë përgjegjësin e hartimit të programeve dhe projekteve tre vjeçare për banim, identifikimi i nevojave për banim, në territorin e komunës përkatëse, sigurimi i zonave për ndërtim dhe pajisja e truallit me infrastrukturë, paraqitjen e kërkesave për subvencionim, në Ministri, krijimin dhe administrimin e bazës së të dhënave për familjet që përfitojnë nga programet për banim, administrimin dhe mirëmbajtjen e banesat me qira dhe raportimin vjetor në Ministri, për ecurinë e programeve të banimit.

Këshilli Qendror për Banim - organi këshillëdhënës pranë Qeverisë së Kosovës lidhur me politikat e banimit.

Organizata joprotabile - që veprojnë në fushën e ndërtimit dhe menaxhimit të banesave me qira.

Donatorët dhe organizatat ndërkombëtare

Në bashkëpunim me OSBE-në, Departamenti i Banimit dhe Ndërtimit nga viti 2010 ka realizuar **5 projekte për ngritjen e kapaciteteve** lokale për zbatimin e ligjeve për banim ku janë përfshirë te gjitha Komunat.

Nga projektet e realizuara është konkluduar se Komunat kanë përvojë të ndryshme sa i përket sigurimit të banimit të përshtatshëm dhe realizimit të programeve të banimit. Kryesisht këto programe kanë qenë vazhdimësi e programeve të rindërtimit pas luftës së fundit në Kosovë dhe nuk janë të përfshira me programet që i mundëson ligji për financimin e programeve të veçanta. Këto programe dhe projekte komunat i kanë bërë në bazë të sigurimit të mjeteve financiare nga donatore të ndryshëm dhe në raste të caktuara nga buxheti i tyre **pa ndonjë planifikim dhe koordinim paraprak**. Do të thotë komuna i është përgjigjur kërkesave ad-hoc dhe nuk ka bërë planifikimin e buxhetit për fushën e banimit. Njëkohësisht u konkludua se komunat nuk kanë themeluar strukturat përkatëse për banim duke u bazuar në nevojat dhe mundësitë e tyre.

Të gjitha komunat kanë kërkuar mbështetje të nivelit qendror në këtë drejtim. U konkludua se nevojë e patjetërsueshme për zbatimin e Ligjit është poashtu edhe krijimi i **data-bazës për regjistrimin dhe monitorimin e të dhënave dhe kërkesave për**

Gjate kesaj periudhe kemi zhvilluar projekte për përkrahje të Komunave ne **hartimin e programeve trevjeçare të banimit** në tetë (8) komuna të Kosovës: K. Fushë Kosovës, K. Graçanicës, K. Ferizajit, K. Gjakovës, K. Klinës, K. Prizrenit, K. Pejës, K. Rahovecit. Deri me tani 17 Komuna kanë hartuar draft/dokumentet të programeve të banimit që kanë involvuar edhe grupet e rrezikuara ndër ta edhe komunitetet RAE që në fazën e hartimit.

| Nr. | Aktivitete | Komunat |
|-----|--|---------|
| 1. | Vendimet për hartimin e programeve trevjeçare te banimit nga Kryetaret te Komunave | 17 |
| 2. | Formimi i Grupit Punues ne nivel Komunal (Komisione) | 17 |
| 3. | Draft/Hartimi i Programeve trevjeçare të banimit në Komuna | 10 |
| 4. | Miratimi i Programeve trevjeçare te banimit ne Kuvendin Komunal | 3 |
| 5. | Themelimi i sektorit për fushën e banimit | 4 |

Rekomandohet të vazhdohet përkrahja për zbatimin i ligjit përmes **hartimit te programeve trevjeçare të banimit në të gjitha Komunat duke përfshirë krijimin e data-bazës për regjistrimin dhe monitorimin e të dhënave dhe kërkesave**, sepse vetëm ne këtë mënyre ofrohet mundësia për integrim të plotë te te gjitha Komuniteteve ne shoqëri. Kjo do te ndikonte edhe ne koordinimin në mes institucioneve vendore dhe ndërkombëtare te cilat janë te përfshira ne këtë çështje.

Ligjet dhe aktet nënligjore

1. Ligjet të cilat ndërlidhen me këtë problem/çështje

- Ligji Nr. 03/L-164 për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit,
- Ligji Nr. 04/L-247 për Shitjen e banesave në të cilat ekziston e drejta e banimit,
- Ligji Nr. 04/L-134 i Ndërtesave të Banimit në Bashkëpronësi,
- Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale me kompetencat komunale neni 17 kompetenca vetanake, pika I) "banimin publik".
- Ligji Nr. 04/L-045 Për partneritet publiko privat,
- Ligji Nr. 03/L-226 Për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës,
- Ligji Nr. 04/L-054 Për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të ushtrisë çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe familjeve të tyre,
- Ligji Nr. 03/L-095 Për Statusin dhe të Drejtat e ish të Dënuarve dhe të Përndjekurve Politik të Kosovës.

2. Aktet nënligjore që ndërlidhen me këtë problem/çështje

- U.A. për Përmbajtjen e kontratës për banesat me qira joprofitabile,
- U.A. për Përmbajtjen e bonusit të banimit,
- U.A. për Kriteret e përcaktimit të radhës së përparësisë për kategoritë e familjeve që mund të përfitojnë nga programet
- U.A. për Procedurat për përfitimin nga programet e veçanta të banimit,
- U.A. për Normat minimale të banimit për banesat e programeve të veçanta të veçanta të banimit,
- U.A. për Procedurat për shpalljen e programeve e veçanta të banimit,
- U.A. për Caktimin e kushteve dhe kriterëve për sigurimin e banimit familjar për invalidët dhe veteranët e UÇK-së dhe familjeve të dëshmorëve,
- U.A. për Caktimin e kushteve dhe kriterëve për sigurimin e banimit familjar për ish të dënuarve dhe ish të përndjekurve politikë.

3. Ligjet në raport me problemin ose çështjen:

- a. **Ligji Nr. 03/L-164 për financimin e programeve të veçanta të banimit:** Qëllimi i këtij Ligji është krijimi i kushteve për banim të qëndrueshëm për familjet ose individët të cilët nuk janë në gjendje ekonomike t'i përballojnë ofertat e tregut të lirë të banesave si dhe caktimi i mënyrës së sigurimit dhe shfrytëzimit të mjeteve financiare për zhvillimin e programeve të veçanta të banimit.
- b. **Ligji Nr. 04/L-061 për shitjen e banesave në të cilat ekziston e drejta e banimit:** Me këtë ligj rregullohen kushtet dhe mënyra e shitjes së banesave në pronësi shoqërore dhe publike për të cilat ekziston e drejta banesore apo e drejta e shfrytëzimit me qira për kohë

të pacaktuar, së bashku me pjesët e përbashkëta dhe pajisjet e ndërtesës si dhe mënyra e përcaktimit të çmimit shitës të banesës dhe shuarja e së drejtës banesore.

- c. **Ligji Nr. 04/L-134 i Ndërtesat të banimit në bashkëpronësi:** Me këtë ligj rregullohen të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e pronarëve të njësive të ndërtesës në lidhje me shfrytëzimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e pjesëve, hapësirave dhe pajisjeve të përbashkëta të ndërtesës - bashkëpronësinë në ndërtesë.
 - d. **Ligji 04/ L - 045 Për partneritet publiko privat:** Me këtë ligj krijohet korniza ligjore për partneritet publiko privat duke përfshirë procedurat për të hyrë në një partneritet publiko privat, përmbajtjen dhe strukturën e marrëveshjeve për partneritet publiko privat si dhe strukturën institucionale përgjegjëse për menaxhimin dhe zhvillimin e partneritetit publiko privat në Republikën e Kosovës.
 - e. **Ligji 03/L-226 Për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës:** me këtë ligj krijohet korniza ligjore për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës përcaktohen të drejtat dhe obligimet e organeve të komunës në menaxhimin e pronës së paluajtshme të komunës në raport me personat fizik dhe juridik, institucionet qendrore dhe Agjencinë Kosovare të Privatizimit.
 - f. **Ligji Nr. 04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile dhe Familjeve të tyre:** me këtë ligj krijohet korniza ligjore për përcaktimi i statusit dhe përkrahja financiare përmes pensioneve dhe beneficioneve të veçanta për kategoritë e dala nga lufta e UÇK-së, të cilat me sakrificën dhe kontributin e tyre ishin faktorë vendimtarë për lirinë dhe çlirimin e vendit.
4. Aktet nënligjore aktuale që ndërlidhen me çështjen/problemin përkatës.
- U.A. për Përmbajtjen e kontratës për banesat me qira joprofitabile: përcakton përmbajtjen dhe formën e kontratës për dhënien e banesës me qira, llojet e qirasë joprofitabile, të drejtat dhe detyrimet e qiradhënësit dhe qiramarrësit, dispozitën e pranim-dorëzimit të banesës me qira, lartësinë e qirasë, shpenzimet e përbashkëta, afatin dhe shkëputjen e kontratës.
 - U.A. për Përmbajtjen e bonusit të banimit: përcaktohet mënyra e përdorimit të bonusit të banimit, banesat për të cilat zbatohet bonusi i banimit, dokumentet e nevojshme për aplikim, afati për gjetjen e banesës nga përfituesit, vlefshmëria e bonusit të banimit, lartësia e bonusit, lartësia e bonusit për raste të veçanta, mënyra e pagesës, njoftimi publik për dhënien e bonusit për banim, verifikimi i nivelit të të ardhurave, llogaritja e buxhetit të nevojshëm, humbja e së drejtës për bonus banim, njoftimi publik për qiradhënësit e banesave, dokumenti i bonusit të banimit edhe njoftimi për ndërprerjen e bonusit të banimit.
 - U.A. për Kriteret e përcaktimit të radhës së përparësisë për kategoritë e familjeve që mund të përfitojnë nga programet: përcakton radhën e përparësisë për përfitim nga

programet e veçanta të banimit për familjet që nuk kanë banesë apo shtëpi në pronësi individuale, kanë mbetur pa banesë-shtëpi si rezultat i dëmtimit të shtëpive gjatë luftës së fundit në Kosovë ose që posedojnë sipërfaqe banimi nën normat minimale të banimit.

- U.A. për Procedurat për përfitimin nga programet e veçanta të banimit: përcakton procedurat e përfitimit nga programet e veçanta të banimit.
- U.A. për Procedurat për shpalljen e programeve e veçanta të banimit: përcakton procedurat e shpalljes së programeve të shpalljes së programeve të veçanta të banimit dhe dokumentacionit të nevojshëm për parashtrimin e kërkesës.
- U.A. për Normat minimale të banimit për banesat e programeve të veçanta të veçanta të banimit: zbatohet me rastin e vlerësimit të objekteve zbatohet me rastin e vlerësimit të objekteve ekzistuese për banim dhe gjatë projektimit të
- objekteve të reja për banim nga programet e veçanta të banimit.
- U.A. për caktimin e kushteve dhe kriterëve për sigurimin e banimit familjar për invalidët dhe veteranët e UÇK-së dhe familjeve të dëshmorëve: të drejtën e përkujdesjes së për banim e realizojnë familjet e Dëshmorëve, Invalidëve, dhe Veteranëve të UÇK-së, që nuk e kanë të zgjidhur çështjen e banimit.
- U.A. për caktimin e kushteve dhe kriterëve për sigurimin e banimit familjar për ish të dënuarve dhe ish të përndjekurve politikë: rregullohen kushtet dhe kriteret për sigurimin e banimit familjar për ish të dënuarit ish, të përndjekurit politikë dhe ish të burgosurit politikë, që nuk e kanë të zgjidhur çështjen e banimit me ndihmën e programit për ndërtimin e objekteve me qira joprofitabile, programit për adaptimin e banesave tjera në pronësi të komunës, programit për dhënien e bonusit për banim të përcaktuar sipas nenit 3, të Ligjit nr. 03/L-164, Për financimin e programeve të veçanta të banimit.

Dokumentet e nivelit qeveritar të cilat në vete përmbajnë aktivitete për zgjidhjen e problemit të banimit janë:

- Strategjia e Komunitetit Romë, Ashkali dhe Egjiptian,
- Strategjia e Kthimit dhe Komuniteteve,
- Strategjia për Vendbanimet Joformale,
- Strategjia Kombëtare për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar

Të gjitha këto duhet të bazohen në bazë të ligji në fuqi.

Financimi i fushës së banimit

Në shumë institucione si nivelin lokal ashtu dhe qendror janë bërë investimet në mënyre ad-hoc çka kjo ka bërë një konfuzion për zhvillimin e politikave të fushës së banimit. Ligji nuk ka të krijuar fond të banimit por vetëm janë të caktuara burimet e financimit të programeve të veçanta të banimit sipas nenit 19 të ligjit për financimin e programeve të veçanta të banimit, sipas mundësive të buxhetit. Kjo ka rezultuar në mos zbatimin e ligjit.

5. Mangësitë e ligjit Për financimin e programeve të veçanta të banimit:

Pas aprovimit të Ligjit Nr. 03/L-164, për financimin e programeve të veçanta të banimit është identifikuar se kategoritë më të varfra kanë mundësi të vogël të përfshirjes në programet që propozon ligji. Për më tepër mundësitë e financimit janë të vogla me ligjin në fuqi andaj është konsideruar e nevojshme inkuadrimi i sektorit privat duke propozuar mënyra të bashkëpunimit në mes sektorit publiko privat.

Paragrafi 2 i nenit 8 përcakton se:

"2. Mirëmbajtja e banesave me qira nga programet e veçanta e banimit kryhet nëpërmjet kontraktimit të personave juridik të licencuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Ky nen do të përputhet me ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-091 për Shfrytëzimin, Administrimin, mirëmbajtjen e ndërtesës në bashkëpronësi në Ligjin Nr. 04/L-134 për Ndërtesat e banimit në bashkëpronësi ku administratorët do të jenë të regjistruar në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor sipas udhëzimit administrativ 06/2014 për Certifikimin e administratorëve të ndërtesave të banimit në bashkëpronësi.

Gjithashtu duhet të bëhen disa ndryshime të cilat bien ndesh me Ligjin për Procedurën Kontestimore lidhur me juridiksionin dhe kompetencën e gjykatës përkatëse për shqyrtimin e kësaj mosmarrëveshje me karakter administrativ si dhe me Ligjin për Procedurat Administrative prandaj, sugjerohet që të riformulohet këto nene.²

Paragrafi 3 i nenit 14 përcakton se:

"3. Pala e pakënaqur me vendimin e Ministrisë, sipas paragrafit 2, të këtij neni, ka të drejtë padie për iniciimin e konfliktit administrativ në Gjykatën Supreme të Kosovës, në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e pranimit të Vendimit." Ky përcaktim në thelb bie ndesh dhe nuk është në harmoni me Ligjin për Procedurën Kontestimore" lidhur me juridiksionin dhe kompetencën e gjykatës përkatëse për shqyrtimin e kësaj mosmarrëveshje me karakter administrativ si dhe me Ligjin për Procedurat Administrative. Prandaj, sugjerohet që ky paragraf të riformulohet si vijon:

"3. Pala e pakënaqur me vendimin e Ministrisë, sipas paragrafit 2, të këtij neni, ka të drejtë të kundërshtojë këtë vendim në gjykatën kompetente brenda tridhjetë (30) ditëve nga dita e pranimit të vendimit". Ky ndryshim do të përshtatet edhe me ndryshimet e organizimit të sistemit gjyqësor në Kosovë.

d. Të ndryshohen paragrafët 1 dhe 5 të nenit 29.

Paragrafi 1 ishte

"1. Në kuptim të këtij ligji, kur shkeljet nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe shqiptohen dënime me gjobë:"

Paragrafi 1 bëhet

² Komentet nga eksperti i CDF-Jordan Daci 2010/11

“1. Në kuptim të këtij ligji, për shkeljet e paragrafëve 1.1, 1.2 dhe 1.3 të nenit 13 kur ato nuk përbëjnë vepër penale, shqiptohen dënime me gjobë:” Ky ndryshim sugjerohet të bëhet për shkak të mungesës së unifikimit të terminologjisë rreth kuptimit të shkeljes administrative si kundërvajtje dhe si shkelje disiplinore, gjë e cila do të bëhet nëpërmjet ligjit për kundërvajtjet etj.

Ligjit Nr. 03/L-164, Për financimin e programeve të veçanta të banimit

Përmes këtij ligj janë të përcaktuar dy programe:

- 1 Programi për banim me qira joprotabile e cila mund edhe të subvencionohet në banesat e ndërtruara nga Komuna, Qeveria dhe Donatorët dhe
- 2 Programi për bonus banimi ku komuna financon gjysmën e qirasë së tregut në banesa ekzistuese në pronësi të personave fizikë apo juridikë.

Përgjegjës për këto programe janë Autoritet Komonale mos themelimi i strukturës së organizimit në nivelin lokal, mungesa e kapaciteteve njerëzore në nivelin qendror dhe mos koordinimi në mes të akterëve relevant, niveli i ultë i çështjes së banimit në prioritet qeveritare dhe mungesat buxhetore janë identifikuar në moszbatimin e të ligjit.

Ndërlidhja e masës së propozuar me këtë koncept me ligjet tjera është:

- Ligji për shitjen e banesave në të cilat ekziston e drejta e banimit,
- Ligji i ndërtesave të banimit në bashkëpronësi.
- Ligji nr. 04/ L - 045 Për partneritet publiko privat
- Ligji nr. 03/L - 226 Për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës.
- Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale me kompetencat komunale neni 17 kompetenca vetanake, pika I) “banimin publik”.

Shpenzimet aktuale

Aktualisht shpenzimet aktuale për fushën e banimit janë duke u shpenzuar nga MMPH, MPB, MKK, komunat dhe donatorët e ndryshëm.

| Kategoria e shpenzimeve | Shpenzimet faktike në vitin paraprak | Buxheti këtë vit | KASH për vitin e ardhshëm |
|---|--------------------------------------|------------------|---------------------------|
| Buxheti i Ministrisë: (shëno secilin lloj të shpenzimit) | | | 115,000.00 |
| Buxhetet tjera: (shëno secilin lloj të shpenzimit) MPB (rindërtimi i shtëpive dhe renovimi) MKK (ndërtimi i 8 shtëpive individuale - 2012) | 100,000.00 | 230,000.00 | 1,000,000.00 |

| | | | | |
|---|------------|------------|--|-----------|
| MPMS | | | | |
| Viti-ndërtimi i banimit social - 30 njësi banimi, | 362.868,58 | | | |
| Ferizaj - 40 shtëpi individuale, | 555.941,48 | | | |
| Podujeve - 30 shtëpi individuale | 367.886,53 | | | |
| Financimi nga donatorët OSBE-punëtoritë | 10.000,00 | 30.000,00 | | |
| Shpenzimet e drejtpërdrejta nga Ministria e Financave - Të hyrat nga ligji për shitjen e banesave për të cilat kanë të drejtër banesore | | 100.000,00 | | 50.000,00 |

Përvoja në shtetet tjera

Banimit social i ofrohet njerëzve në bazë të mekanizmave të ndryshëm ligjor varësisht prej shteteve. Shtetet e rajonit të cilat kanë kaluar nëpër të njëjtat ngjarje historike të zhvillimit po thuajse kanë të njëjtat mekanizma trajtimi të këtyre rasteve. Banimit social në shtete e rajonit si: Shqipëria, Sllovenia, Mali i Zi, Serbia, disa Kantone të Bosnjës është zgjidhur nëpërmjet ligjeve për banim social, disa nëpërmjet ligjeve më gjeneral siç është Sllovenia dhe Maqedonia nëpërmjet Ligjeve për banim, Kroacia nëpërmjet ligjit për përkujdesje sociale, ndërsa shtetet tjera me ligj të veçantë për banim social.

Shtetet e BE-së banimin social e kanë të rregulluar më mekanizma të ndryshëm varësisht prej nevojës për zhvillimin e tij. Disa shtete kanë politika qendrore si Britania e Madhe (Ligji për banim), Franca dhe Italia, ndërsa shtetet tjera si Austri, Gjermania, Suedia, Holanda banimin social e zhvillojnë nëpërmjet nivelit lokal dhe regional të qeverisjes. Në shtetet e Evropës si dhe në disa të rajonit zhvillimin e banimit social e ndihmojnë agjencitë joprofitabile ose me profit të limituar (si. p.sh. Vjena) si dhe bashkëpunimi i sektorit publiko privat.

Varësisht prej nevojave të shteteve banimit social është zhvilluar në mënyra të ndryshme duke trajtuar kategori të ndryshme (p.sh. në Slloveni është banimi me qira joprofitabil me kategoritë e synuara familjet e reja dhe të moshuarit, ndërsa Bosnja dhe Kroacia ka zhvilluar banimin social për kategoritë e dala nga lufta pa ndonjë ligj specifik për banim social).

- Nga projekti i binjakëzimit në mbështetje të MMPH-së, konsulentat e ekspertëve kanë dhënë rekomandimet që në Kosovë nëpërmjet strategjisë kombëtare 10 vjeçare të planifikohet involvimi i sektorit privat në ofrimin e banimit social meqë buxheti shtetëror është i limituar dhe fondi për banim mungon edhe atë duke ofruar mundësi në zhvillimin e projekteve me partneritet publiko-privat me qëllim të shtimit të banesave me qira të subvencionuar
- koncensionimin e tokës nga komunat;
- krijimin e OJQ-ve ose strukturave të ngjashme me profit të limituar që do të merreshin me zhvillim dhe menaxhimin e banesave me qira të subvencionuar nga shteti.

Kapitulli 3: Synimet dhe objektivat

Synimi

Synimi kryesor nga propozimi i plotësim/ndryshimit të politikës ekzistuese në fushën e banimit social është realizimi i plotë i së drejtës për banim sipas Kushtetutës dhe legjislacionit të BE-së.

Objektivat

1. Krijimi i një sistemi unik ligjor dhe institucional për rregullimin e banimit social.

Me politikën e propozuar synohet të arrihet:

- Rritja e ofertës për banim social
- Përafrimi i politikave evropiane në fushën e banimit
- Hartimin e Strategjisë Kombëtare të Banimit për periudhën prej dhjetë (10) viteve,
- Nxitjen e sektorit privat dhe organizatave joqeveritare përgjegjëse për ndërtime, renovime dhe mirëmbajtje të banesave sociale dhe banesat me qira joprofitabile.

Pjesa 4: Opsionet

Opsioni 1: Opsioni status quo (asnjë ndryshim)

Ligji Nr. 03/L-164, Për financimin e programeve të veçanta të banimit ka hasur në pengesë për zbatim sidomos në mungesë të mundësive për kategoritë më të varfra që sipas tij kanë mundësi të vogël të përfshirjes në programe. Për më tepër mundësitë e financimit janë të vogla me ligjin në fuqi andaj është konsideruar e nevojshme inkuadrimi i sektorit privat duke propozuar mënyra të bashkëpunimit në mes sektorit publiko privat.

Pengesë tjetër në zbatimin e ligjit përveç mungesave buxhetore është konsideruar edhe mungesa e strukturës organizative nëpër komuna. Mos koordinimi në mes të institucioneve qendrore në mes veti si dhe me nivelin lokal dhe me donatorët ka paraqit një pengesë në zbatim të ligjit ose ngecje në fuqizimin e zbatimit të ligjit.

Ky mos koordinim është rezultat i mos harmonizimit të disa strategjive që kanë përfshirë fushën e banimit në mënyra të ndryshme edhe pse komentet e MMPH gjithmonë kanë qenë bazuar në kornizën ligjore. Edhe pse Departamenti në MMPH ka organizuar disa punëtori për promovimin e ligjit, meqenëse zyrtarët pjesëmarrës në punëtori janë ndryshuar dhe nuk ka pasur kontinuitet të informatave, shumica e institucioneve nuk janë të informuar me dispozitat e këtij ligji andaj varësisht prej donatorëve investimet janë orientuar pa ndonjë harmonizim.

Me ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-091 Për shfrytëzimin administrimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesës në bashkëpronësi në Ligjin Nr. 04/L-134 i Ndërtesat të banimit në bashkëpronësi në të cilën është referuar ligji në fuqi sa i përket të administrimit dhe mirëmbajtjes së ndërtesave të banimit është paraqitur nevoja që këto ndryshime të reflektohen edhe në këtë ligj.

Gjithashtu dispozitat kalimtare nuk janë në harmoni dhe bien ndesh me Ligjin për Procedurën Kontestimore lidhur me juridiksionin dhe kompetencën e gjykatës përkatëse për shqyrtimin e kësaj mosmarrëveshje me karakter administrativ si dhe me Ligjin për Procedurat Administrative prandaj, sugjerohet që ky paragraf në ligjin në fuqi të riformulohet.

Alternativa e status-quo do të thotë të mos bëhet asgjë sa i përket problemit të banimit për familjet që nuk përfshihen në këtë ligj dhe të vazhdohet me trendin aktual çka do të thotë mos trajtimi i të gjitha kategorive si dhe mos koordinimi i kompetencave dhe institucioneve tjera.

Opsioni 2: Ndryshim/plotësimi i politikës ekzistuese

Alternativa e rekomanduar është ndryshimi i Ligjit Nr. 03/L-164 për financimin e programeve të veçanta të banimit për faktin se Ligji në fuqi ka filluar të zbatohet në disa komuna, aktualisht janë duke u zhvilluar projekte për ngritje të kapaciteteve për zbatimin e tij mirëpo informatat nuk po përcjellën në mungesë të strukturës përkatëse për banim në komuna.

Ligji në fuqi ka propozuar krijimin e strukturës së banimit në komuna, dispozitë kjo që nuk është zbatuar në përgjithësi andaj duhet të obligohen Komunitetet për funksionalizimin e kësaj strukture aty ku ekziston dhe inicimin e themelimit të saj aty ku nuk ekziston. Në harmonizim të veprimeve për banim do të ndihmonte krijimi i bazës së të dhënave si instrument i këmbimit të informatave nga të gjithë akterët që merren me zgjidhjen e çështjes së banimit.

Kostoja mesatare e ndërtimit sipas ligjit në fuqi definohet në bazë të përvojave të mëhershme të MMPH-së dhe informatave të mbledhura me anketë nga kompanitë ndërtimore në Kosovë. Kjo procedurë është e përcaktuar në ligjin në fuqi nuk propozohet të ndryshohet.

Mënyra e përcaktimit të kufijve të të ardhurave dhe qirasë do të thjeshtohet duke mos përdorur formulat sepse në mënyrën e përcaktimit të ligjit në fuqi është më e vështirë për t'u zbatuar dhe më e komplikuar. Këto sugjerime janë edhe nga ekspertët që kemi pasur konsultime rreth këtij ligji.

Propozimi i politikës së re është që të përcaktohen kufijtë fiks që janë 150-300 euro. Ky kufi i të ardhura vlen për familjet me të ardhura të ulëta ndërsa niveli i të ardhurave për familjet me asistencë sociale është nën këtë limit.

Në Kosovë janë identifikuar shumë kategori që kanë nevojë për përkrahje për banim si:

- Familjet që jetojnë nën norma e banimit.
- Kategoritë e dalura nga lufta,
- Kategoritë e ish të burgosurve dhe përndjekurve politikë,
- Të kthyerit nga shtetet e rajonit dhe të zhvendosurit brenda vendit,
- Komuniteti Rome Ashkali dhe Egjiptian,
- Riintegrimin e personave të riatdhesuar.

Dy kategoritë e mëdha që i propozon ligji e që si kriter kanë nivelin e të ardhurave përveç familjeve me të ardhura të ulëta që janë të përfshira në ligjin në fuqi propozojmë të shtohet edhe kategoria e familjeve me asistencë sociale duke propozuar si zgjidhje të banimit, përveç programeve të parapara në ligjin në fuqi të shtohen programe ku do të subvencionohet qiraja joprofitabile deri në nivelin e mundësisë së pagesës së tyre e që është 30% e të ardhurave familjare.

Plotësimi/Ndryshimi i ligjit synon në zbatimin në përputhshmërinë e tij me aktet tjera ligjore në fuqi me ndryshimin e të cilave afektohet zbatimi i këtij ligji si aktet ligjore që rregullojnë funksionimin e Gjykatave, ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-091 Për shfrytëzimin administrimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesës në bashkëpronësi në Ligjin Nr. 04/L-134 i Ndërtesat të banimit në bashkëpronësi.

Opsioni 3: Ndryshimi i politikës ekzistuese

Politika e re do të përmbajë rritjen e mënyrave dhe masave stimuluese ose masave të detyrueshme ndaj sektorit privat me qëllim të rritjes së mundësive të financimit dhe të shtimit të programeve të banimit duke i përfshirë të gjitha kategoritë që nuk janë përfshirë në mënyrë specifike në ligjin në fuqi si:

- **masa të detyrueshme ose masa stimuluese** për komunat ashtu që në zonat ku ka nevojë të konsiderueshme për përkrahje në banim sociale të kërkoj nga sektori privat që në projektet e ndërtimit (ndërtuar në një ngastër private) me kapacitet mbi 25 banesa një përqindje të banesave të ndaj për banim me qira joprofitabile (p.sh. 10%) ose të subvencionohen ndërtuesit privat nga komunat ashtu që një përqindje (po ashtu mund të propozohet 10% për ndërtesat me më shumë se 25 banesa) të ndahet për banim me qira joprofitabile e që këto marrëveshje realizohen gjatë lëshimit të lejes së ndërtimit nga komunat e cila mund të stimulohet ose ndonjë masë tjetër e stimulimit.
- Një lloj **mase tjetër stimuluese** është edhe kur Komuna apo shteti është pronar i tokës dhe që me projekte për zhvillim i jep tokën me koncesion kompanisë private që të ndërtoj dhe të ndaj një përqindje të banesave për banim me qira joprofitabile.

Për zbatimin e politikës duhet të rriten burimet shtesë financiare dhe ngritjen e kapaciteteve të institucioneve relevante për zbatimin e ligjit.

Propozimi i ligjit të ri tenton t'i jep rol më të madh organizatave joprofitabile ashtu që rezultatet në terren të jenë më të mëdha

Për më tepër propozimi i ri përfshinë hartimin e strategjisë dhjetë vjeçare qendrore të banimit në bazë të së cilës hartohen dokumentet planifikuese komunale.

Propozimi i ligji të ri mundëson krijimin e një sistemi të banimit social në Kosovë, ku do të përfshiheshin të gjitha kategoritë në nevojë për banim, duke i paraparë bashkëfinancimet nga Buxheti i Kosovës dhe sektori privat si dhe donatorët.

Si do të sigurohet koordinimi, mbikëqyrja dhe monitorimi i zbatimit të politikës në nivelin e institucioneve qendrore me nivelin lokal?

Obligimi në përcaktimin e strukturës për zhvillimin e politikave të banimit dhe zbatimin e tyre si në nivel qendror dhe lokal si dhe përcaktimi i takimeve vjetore në mes institucioneve qendrore dhe atyre lokale do të jenë masa të propozuara kundrejt mos zbatimit të dispozitës ligjore që obligon institucionet në ngritje të strukturave dhe koordinim mes tyre.

Me ligjin e ri propozohen

Opsioni 4 : Ndryshimi i qasjes ekzistuese të zbatimit

- masa të detyrueshme ose masa stimuluese për komunat ashtu që në zonat ku ka nevojë të konsiderueshme për përkrahje në banim sociale të kërkoj nga sektori privat. tentohet t'i jepet rol më i madh organizatave joprofitabile ashtu që rezultatet në terren të jenë më të mëdha.

- Kërkimi i burimeve shtesë të financimit;
- Vazhdim i ngritjes së kapaciteteve të institucioneve relevante për zbatimin e ligjit
- Marrëveshje me komunat

Koordinim më i mirë institucional dhe me donatorë etj. **LIGJI DO TE PERMBAN:**

PJESA I-DISPOZITA TË PËRGJITHSHME - Fushëveprimi dhe përkufizimet, Përkufizimet Strategjia Kombëtare e Banimit, Përmbajtja e Strategjisë Kombëtar të Banimit, Programet trevjeçare komunale të banimit, Kategoritë e shfrytëzuesve të Programet e Banimit Social, Kriteret për përcaktimin e radhës me prioritet për qasje në Programet e Banimit Social

PJESA II-ORGANIZIMI INSTITUCIONAL - Përgjegjësitë e Ministrisë, Përgjegjësitë e Komunave, Këshilli Qendror për Banim.

PJESA III- INCIANTIVAT DHE PERFITIMET - Iniciativat dhe përfitimet për të mbështetur sektorin Banim Social, Nxitjet, Përfitimet, Procedurat, Verifikimi i kushteve për Përfituesve për qasje në përfitime

PJESA IV - SEKTORI PËR BANIM ME QIRA - Shfrytëzuesit e banimit social, Menaxhimi dhe Mirëmbajtja e banesave, Tarifa e qirasë joprofitabile, Siguria dhe kushtet e jetesës të banesave sociale, Kontrata me qira joprofitabile, Të drejtat dhe detyrimet e qiramarrësit

PJESA V - DISPOZITA TË PËRGJITHSHME - E drejta e ankimit, Ngritja e kapaciteteve, Mbikëqyrje, Inspektimet

PJESA VI DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE - Dispozitat shfuqizuese, Hyrja në fuqi

Pjesa 5: Përmbledhje e opsioneve

Propozojmë një sërë alternativash të mundshme. Alternativa e rekomanduar është hartimi i ligjit për banim social.

| Përmbledhja e opsioneve | | | | |
|--------------------------|----------------------|---|----------------------------------|---|
| Karakteristikat kryesore | Opsioni 1 Status-quo | Opsioni 2 plotësim ndryshimi i kornizës aktuale | Opsioni 3 Hartimi i Ligjit të ri | Opsioni 4 Ndryshimi i qasjes ekzistuese të zbatimit |
| Karakteristikat | Trendi aktual | Nevoja për | Përmbushja e | |

| | | | | |
|---|---|---|---|--|
| kryesore të opsionit | | ndryshimin dhe përfshirjen e numrit të madhe të kategorive. | obligimeve shtetërore për përkrahjen e grupeve të rrezikuara në mënyrë institucionale dhe dhënien e mjeteve financiare shtesë për të ndihmuar zbatimin e ligjit | |
| Segmenti i popullsisë/sekto ri/rajoni i shënjestruar | Kategoritë me të ardhura të ulëta | Personat me asistencë sociale, personat e të kthyer nga vendet e rajonit, familjet me të ardhura të ulëta, komunitetet Romë, Ashkali dhe Egjiptian, familjet e invalidëve dhe veteranëve të UÇK-së dhe familjeve të dëshmorëve, të ish burgosurve politik si dhe personat të riatdhesuar. | Kategoritë e rrezikuara (familjet me asistencë sociale) | |
| Karakteristikat e zbatimit - kush është përgjegjës - një resor i Qeverisë (cili), sektori privat, qytetarët | Kompetencë e definuar e MMPH | MMPH, Komunitat, OJQ, Sektori privat | MMPH, Komunitat, OJQ Sektori privat | |
| Administrimi ose zbatimi i programit ose shërbimit | Kompetencë e definuar e MMPH | MMPH, Komunitat, OJQ. | MMPH, Komunitat OJQ. | |
| Ligjet, aktet nënligjore, ndryshimet dhe plotësimet e ligjeve ekzistuese si dhe zbatimi dhe | <ul style="list-style-type: none"> Ligji për financimin e programeve të veçanta të banimit, Ligji për | Plotësim-ndryshimi i Ligjit për financimin e programeve të veçanta të banimit dhe udhëzimeve administrative | Ligji për banim social, hartimi i udhëzimeve administrative | |

| | | | | |
|----------------|---|--|--|--|
| <p>dënimet</p> | <p>shitjen e banesave në të cilat ekziston e drejta e banimit,</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ligji i Ndërtesave të banimit në bashkëpronësi, • U. A. për Përmbajtjen e kontratës për banesat me qira joprofitabile, • U.A. për Përmbajtjen e bonusit të banimit, • U.A. për Kriteret e përcaktimit të radhës së përparësisë për kategoritë e familjeve që mund të përfitojnë nga programet • U. A. për Procedurat për përfitimin nga programet e veçanta të banimit, • U.A. për Normat | | | |
|----------------|---|--|--|--|

| | | | | |
|--|---|--|--|--|
| | <p>minimale të banimit për banesat e programev e të veçanta të veçanta të banimit,</p> <ul style="list-style-type: none"> • U. A. për Procedurat për shpalljen e programev e e veçanta të banimit, • U.A. për caktimin e kushteve dhe kriterëve për sigurimin e banimit familjar për invalidët dhe veteranët e UÇK-së dhe familjeve të dëshmorëve, • U.A. për caktimin e kushteve dhe kriterëve për sigurimin e banimit familjar për ish te dënuarve dhe ish të përndjekurve politikë. | | | |
|--|---|--|--|--|

| | | | | |
|--|---|--|---|--|
| Stimulimet ose mos- stimulimet ekonomike – subvencionet ose taksat | Në mungesë e buxhetit nuk janë zbatuar subvenciono het | Parashihen subvencionet nga nivelin lokal dhe nga niveli qendror | Krijimi i masave për stimulim të programeve dhe krijimi i stokut të banimit në nivelet lokale | |
| Fushatat e edukimit dhe komunikimit | Janë realizuar 5 projekte për ngritje të kapaciteteve për zbatimin e ligjit në nivel lokal në të gjitha komunat | Parashihen fushata promovuese dhe vetëdijesuese | Parashihen fushata promovuese dhe vetëdijesuese | |
| Udhëzimet | Në harmoni me standardet e BE-së | Në harmoni me standardet e BE-së | Në harmoni me standardet e BE-së | |
| Afatet kohore - kur hyn në fuqi opsioni | Është në fuqi | Deri në vitin e ardhshëm 2014 | Deri në vitin 2014 | |

Pjesa 6: Analiza e opsioneve

Opsioni 1. (status quo). Ligji Nr. 03/L-164, Për financimin e programeve të veçanta të banimit ka hasur në pengesë për zbatim sidomos në mungesë të mundësive për kategoritë më të varfra që sipas tij kanë mundësi të vogël të përfshirjes në programe. Për më tepër mundësitë e financimit janë të vogla me ligjin në fuqi andaj është konsideruar e nevojshme inkuadrimi i sektorit privat duke propozuar mënyra të bashkëpunimit në mes sektorit publiko privat.

Opsioni 2. Me ndryshimin e Ligjit propozohet rritja e kategorive përfituese, rritje e programeve të banimit si dhe ndryshimi i gabimeve teknike, reflektimi i ndryshimeve të legjislacionit që kanë lidhshmëri me ligjin ekzistues dhe në të cilin Ligji ekzistues referohet për çështjen e Gjykatave dhe administrimit të ndërtesave të banimit në bashkëpronësi.

Me këtë opsion nuk arrihen rezultatet e synuara por mund të ndikojë në rritje të zbatimit të ligjit në fuqi.

Opsioni 3. Propozimi i politikës së re përmban dispozita për rritjen e mënyrave dhe masave stimuluese ose masave të detyrueshme ndaj sektorit privat me qëllim të rritjes së mundësive të financimit dhe të shtimit të programeve të banimit duke i përfshirë të gjitha kategoritë që nuk janë përfshirë në mënyrë specifike në ligjin në fuqi. Në Kosovë janë identifikuar shumë kategori

që kanë nevojë për përkrahje për banim si: familjet që jetojnë nën norma e banimit, kategoritë e dalura nga lufta, kategoritë e ish të burgosurve dhe përndjekurve politikë, të kthyerit nga shtetet e rajonit dhe të zhvendosurit brenda vendit, komuniteti Romë Ashkali dhe Egjiptian, Riintegrimin e personave të riatdhesuar.

Masa si masa të detyrueshme ose masa stimuluese për komunat ashtu që në zonat ku ka nevojë të konsiderueshme për përkrahje në banim sociale të kërkoj nga sektori privat. Propozimi i ligjit të ri tenton t'i jep rol më të madh organizatave joprofitabile ashtu që rezultatet në terren të jenë më të mëdha.

Një lloj mase tjetër stimuluese është edhe kur Komuna apo shteti është pronar i tokës dhe që me projekte për zhvillim i jep tokën me koncesion kompanisë private që të ndërtoj dhe të ndaj një përqindje të banesave për banim me qira joprofitabile.

Për zbatimin e politikës duhet të rriten burimet shtesë financiare dhe ngritjen e kapaciteteve të institucioneve relevante për zbatimin e ligjit.

Kostoja financiare:

Me ndryshim të Ligjit Nr, 03/L-164 Për financimin e programeve të veçanta të banimit - banim social kërkohet një kosto shtesë dhe konkludohet se ka implikime financiare,

| Përmbledhje e Vlerësimit të Ndikimit Financiar | | | | | |
|---|------------|--------------------------|--------------------------|--------------------------|--------------------------|
| | (000 Euro) | | | | |
| | 2013 | Viti aktual | Viti 2 | Viti 3 | Viti 4 |
| Opsioni 1 | | | | | |
| Diferenca neto në alokimin e shpenzimeve MMPH - ndërtimi i njësive banesore | 230,000.00 | 850,000.00 | 600,000.00 | 800,000.00 | 900,000.00 |
| Diferenca neto në gjenerimin e të hyrave | | | | | |
| Financimi i pritur nga donatorët | 30,000.00 | 1,000,000.00 | 1,000,000.00 | 1,000,000.00 | 1,000,000.00 |
| Opsioni 2 | | | | | |
| Diferenca neto në alokimin e shpenzimeve MMPH - ndërtimi i njësive banesore | 230,000.00 | 125,000.00 850,000.00 | 125,000.00 600,000.00 | 125,000.00 800,000.00 | 125,000.00 900,000.00 |
| Partneriteti publiko-privat | | | | | |
| Diferenca neto në gjenerimin e të hyrave | 21,600.00 | 54,000.00 | 108,000.00 | 162,000.00 | 216,000.00 |

| | | | | | |
|---|------------------------|--------------------------|--|--|--|
| Qiraja joprofitabile Bonus banimi Qiraja e lokaleve afariste | | 43,200.00 | 64,800.00 | 86,400.00 | 108,000.00 |
| Financimi i pritur nga donatorët | 30,000.00 | 1,000,000.00 | 1,000,000.00 | 1,000,000.00 | 1,000,000.00 |
| Opsioni 3 | | | | | |
| Diferenca neto në alokimin e shpenzimeve MMPH - ndërtimi i njësive banesore | 230,000.00 | 125,000.00 850,000.00 | 150,960.00 125,000.00 600,000.00 | 150,960.00 125,000.00 800,000.00 | 150,960.00 125,000.00 900,000.00 |
| Diferenca neto në gjenerimin e të hyrave Qiraja joprofitabile Bonus banimi Qiraja e lokaleve | 54,000.00 21,600.00 | 108,000.00 43,200.00 | 162,000.00 64,800.00 | 216,000.00 86,400.00 | 270,000.00 108,000.00 |
| Financimi i pritur nga donatorët | 30,000.00 | 1,000,000.00 | 1,000,000.00 | 1,000,000.00 | 1,000,000.00 |

Pjesa 7: Konsultimi

Nevoja për ndryshimin e ligjit ka rrjedhur gjatë bashkëpunimit me Komunat, Ministrinë si dhe ekspertët që kanë kontribuar në Ministri.

Gjatë promovimit të ligjit në fuqi nëpër Komuna si dhe gjatë hartimit të programeve trevjeçare të banimit nëpër Komuna është evidentuar si të nevojshme që të shtohen edhe programe tjera që nuk janë përfshirë në këtë ligj.

Gjithashtu ekspertët që kanë kontribuar në DBN kanë propozuar disa ndryshime si në aspektin teknik edhe në përmbajtje të ligjit. Nga eksperti ligjor të angazhuar nga CDF për fushën e banimit janë evidentuar disa probleme teknike e që janë vërejtur gjatë hartimit të akteve nënligjore për zbatim e Ligji. Janë propozuar disa ndryshime të cilat synojnë zbatimin efikas të këtij ligji, përputhshmërinë e tij me aktet tjera ligjore në fuqi me ndryshimin e të cilave afektohet zbatimi i këtij ligji si aktet ligjore që rregullojnë funksionimin e Gjykatave, aktet ligjore që rregullojnë administrimin e ndërtesave në bashkëpronësi dhe të ngjashme si dhe synojnë lehtësimin e kuptimit të këtij ligjit.

Po ashtu ekspertët e projektit të binjakëzimit kanë rekomanduar që të bëhen ndryshime në përmbajtjen e programeve, format e reja të financimit për të rritur mundësitë për implementimin e këtyre programeve, përfshirjen e kategorive tjera në këto programe, mundësitë e koncensionimit të tokës nga komunat dhe mënyra e projekteve me partneritet

publiko-privat me qëllim të shtimit të banesave me qira të subvencionuar, mundësimi i krijimit të OJQ-ve ose struktura të ngjashme me profit të limituar që do të merreshin me zhvillimin dhe menaxhimin e banesave me qira të subvencionuar nga shteti.

Për këtë arsye janë propozuar mundësitë alternative të financimit publik. Këto masa mund të përfshijnë **masa stimuluese ose masa të detyrueshme** që Ligji mund të ndryshohet për të lejuar komunat në zonat ku ka një nevojë të rëndësishme të programeve sociale të banimit të kërkoj që projektet e ndërtimit (zhvilluar në një ngastër private) të një madhësie të caktuar (të vlerësohet rast pas rasti) të përfshijë një përqindje të caktuar shoqërore banim (p.sh. 20%). Ky lloj i masës do të integroj sistemin në Kosovë (si në Francë) kur Komuna apo shteti është pronar i tokës që mund të marrin pjesë në projektin e zhvillimit me kontribut në natyrë tokës dhe të marrë në konsideratë një pjesë e ndërtesës.

Konsultimi me ministrinë e tjera

Në procesin e riadhesimit të personave të riadhesuar ku bartës është MPB është rritur numri i kërkesave për banim sipas strategjisë kombëtare të personave të riadhesimit dhe fusha e banimit i u është deleguar Ministrisë tonë përmes duke zbatuar politikat qendrore që i ka fusha e banimit duke i zbatuar në komuna si kompetencë sipas Ligjit të vetëqeverisjes lokale dhe ligjit në fuqi. Në bazë të kësaj nga fondi i riintegritimit është realizuar marrëveshja në mes dy ministrive (MMPH dhe MPB) që çdo vit barten 1.000.00 euro për zgjidhjen e problemeve të banimit në bazë të strategjisë së janë të hartuar në nivelin qeveritar.

Gjithashtu gjatë takimit të nivelit qeveritar të mbajtur në Selanik (dhjetor 2013), gjatë të cilit veçanërisht janë priorizuar fushat e banimit, e-qeverisjes dhe zhvillimi i decentralizimit dhe kapaciteteve si fusha në të cilat duhet përqendruar koordinimin, bashkëpunimin dhe programimin e përbashkët në mes të ministrive relevante dhe subjekte partnere.³

Pjesa 8: Krahasimi i opsioneve

Pasojë e opsionit 1 është se Ligji Nr. 03/L-164, Për financimin e programeve të veçanta të banimit ka hasur në pengesë për zbatim sidomos në mungesë të mundësive për kategoritë më të varfra që sipas tij kanë mundësi të vogël të përfshirjes në programe, mos-koordinimi në mes donatorëve të ndryshëm dhe institucioneve vendore kanë zgjidhur raste specifike me zgjidhje ad-hok që shpesh herë janë jo të qëlluara dhe më të kushtueshme Me opsionin e dytë- plotësim ndryshimi i Ligjit në fuqi, shtohen programet e banimit dhe kategoritë përfituese si dhe bëhen plotësim ndryshimet e dispozitave që janë relevante me disa ligje që janë ndryshuar sa i përket proceduarve të ankesave në Gjykata si dhe administrimit të ndërtesave të banimit në bashkëpronësi por që nuk lejohet ndryshim më i madh se kaq. Për të arritur rezultate më të mira në kompletim të bazës ligjore për banim social kemi konstatuar se ka nevojë për Propozimi i politikës së re- Opsioni 3.

Propozimi i politikës së re përmban dispozita për rritjen e mënyrave dhe masave stimuluese ose masave të detyrueshme ndaj sektorit privat me qëllim të rritjes së mundësive të financimit dhe

³ Deklarata e miratuar gjatë takimit ndërministror

të shtimit të programeve të banimit duke i përfshirë të gjitha kategoritë që nuk janë përfshirë në mënyrë specifike në ligjin në fuqi.

Me Propozim-ligjin e ri propozohen

- Hartimi i strategjisë kombëtare dhjetë vjeçare e cila ka ngecur së hartuari me ligjin në fuqi ngaqë ka qenë e përcaktuar të hartohet në bazë të programeve trevjeçare komunale të banimit të cilat kanë ngecur së hartuari
- masa të detyrueshme ose masa stimuluese për komunat ashtu që në zonat ku ka nevojë të konsiderueshme për përkrahje në banim sociale të kërkoj nga sektori privat.
- tenton t'i jep rol më të madh organizatave joprofitabile ashtu që rezultatet në terren të jenë më të mëdha.
- mase tjetër stimuluese është edhe kur Komuna apo shteti është pronar i tokës dhe që me projekte për zhvillim i jep tokën me koncesion kompanisë private që të ndërtoj dhe të ndaj një përqindje të banesave për banim me qira joprofitabile.
- të rriten burimet shtesë financiare dhe ngritjen e kapaciteteve të institucioneve relevante për zbatimin e ligjit.

Pjesa 9: Rekomandimi

Si opsioni më i mirë konsiderohet Hartimi i Ligjit të ri për Banim Social- Opsioni 3,ku mendohet të arrihet synimi dhe objektivat e fushës së banimit.

MMPH planifikon të përgatisë projekt Ligjin e ri për Banim Social në bazë të koncept dokumentit/opsionit 3 të miratuar dhe të dorëzoj projekt/ligjin për Banim social për miratim në Qeveri . Këtë do ta bëjë MMPH deri në afatin kohor K3.

Kostoja e përafërt për zbatimin e Ligjit do jetë???

Pjesa 10: Komunikimi lidhur me ndryshimet e propozuara planifikohet pas ndryshimit dhe aprovimit të tij. Planifikohen aktivitete promovuese të Ligjit nëpër komuna, takime me qytetarë si dhe promovimi me publikime e fletushka.

1. Minsitria do të komunikoj dhe bashkëpunoj me të gjitha Ministrite tjera,
2. Minsitria do të komunikoj dhe bashkëpunoj me të gjitha Komunat e Kosovës,
3. Komunikimi do të bëhet menjëherë pas aprovimit të ligjit duke e promovuar nëpër Komuna.
4. Do të bëhen shpallje publike nëpër komuna për të informuar popullatën e tyre në judiksonit e vet.